

VENDIM
Nr. 209, datë 29.3.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË ITALISË, PËR NJOHJEN E NDËRSJELLË TË LEJEVE TË
DREJTIMIT ME QËLLIM KONVERTIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit me qëllim konvertimi, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË
MBI NJOHJEN E NDËRSJELLË TË LEJEVE TË DREJTIMIT ME
QËLLIM KONVERTIMI

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Italisë, në vijim të quajtura "Palët",

me qëllim që t'u japin titullarëve të lejeve të drejtimit të lëshuara nga autoritetet kompetente të njërës prej Palëve, mundësinë e konvertimit në leje drejtimi të lëshuara nga autoritetet kompetente të Palës tjetër, si dhe për të përmirësuar sigurinë e transportit rrugor dhe për të lehtësuar trafikun rrugor në territoret përkatëse,

duke pasur parasysh Konventën për qarkullimin rrugor të bërë në Vjenë më 8 nëntor 1968,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët njohin në mënyrë të ndërsjellë, për qëllime konvertimi, lejet e drejtimit jo të përkohshme dhe brenda afatit të vlefshmërisë, që janë lëshuar nga Autoritetet kompetente të Palës tjetër, sipas legjislacionit të tyre të brendshëm, në favor të titullarëve të lejeve të drejtimit që marrin rezidencën në territorin e tyre.

Palët nuk i njohin lejet e drejtimit të përkohshme dhe nuk mund të lëshojnë, për konvertim, leje drejtimi të përkohshme.

Neni 2

Leja e drejtimit e lëshuar nga Autoritetet e njërës prej Palëve pushon së qenuri e vlefshme për qëllime qarkullimi në territorin e Palës tjetër, pasi ka kaluar një vit nga data e marrjes, nga ana e titullarit, të rezidencës në territorin e Palës tjetër.

Neni 3

Në kuadrin e interpretimit të neneve të kësaj Marrëveshjeje, me “rezidencë” nënkuptohet sa është përcaktuar dhe rregulluar nga legjislacioni në fuqi i secilës Palë.

Neni 4

Titullari i lejes së drejtimit të lëshuar nga Autoritetet e njëres prej Palëve, i cili vendos rezidencën në territorin e Palës tjetër, mund ta konvertojë lejen e tij të drejtimit pa qenë nevoja të kryejë prova teorike dhe praktike, përveçse në situata të veçanta në të cilat është e nevojshme një provë praktike drejtimi. Konsiderohen situata të veçanta, ato që kanë të bëjnë me drejtuesit me kërkesa të veçanta që kërkojnë përshtatje të automjeteve, krahasuar me konfigurimin standard ose përdorimin e protezave.

Titullari i një leje drejtimi të lëshuar nga Autoritetet e njëres prej Palëve, mund të kërkojë konvertimin e lejes së tij të drejtimit, vetëm nëse është rezident në territorin e Palës që do të procedojë me konvertimin, prej më pak se katër vjetësh në momentin e paraqitjes së kërkesës për konvertim. Përndryshe kjo Marrëveshje nuk gjen zbatim.

Autoritetet kompetente mund të kërkojnë një certifikatë mjekësore që vërteton gjendjen psikofizike të nevojshme për kategoritë e kërkuara në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi të Palëve.

Për zbatimin e paragrafit të parë të këtij neni, titullari i lejes së drejtimit duhet të ketë arritur moshën minimale të parashikuar nga legjislacionet e brendshme përkatëse për lëshimin e kategorisë për të cilën ai kërkon konvertimin.

Kufizimet e drejtimit të automjetit dhe çdo ndëshkim i parashikuar në lidhje me datën e lëshimit të lejes së drejtimit nga dispozitat e brendshme të Palëve zbatohen duke iu referuar datës së lëshimit të lejes fillestare, për të cilën kërkohet konvertimi.

Neni 5

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen vetëm për lejet e drejtimit të lëshuara përpara marrjes së rezidencës nga titullari në territorin e Palës tjetër dhe, në rast se ato janë lëshuar me vlefshmëri të përkohshme, ato zbatohen vetëm kur janë bërë të vlefshme në mënyrë të përhershme para marrjes së rezidencës së lartpërmendur.

Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për ato leje drejtimi që nga ana e tyre janë marrë në zëvendësim të një dokumenti të lëshuar nga një shtet tjetër dhe që nuk mund të konvertohet në territorin e Palës që do të procedojë me konvertimin.

Neni 6

Në momentin e konvertimit të lejes së drejtimit, ekuivalenca midis kategorive të lejeve të drejtimit të lëshuara nga të dyja Palët përcaktohet nga Autoritetet kompetente të Palëve në bazë të Tabelave të Ekuivalencës bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje.

Titullari i lejes së drejtimit të lëshuar nga autoritetet e të dy Palëve e konverton atë nëse përputhet me një nga modelet e listuara në listën e Modeleve të lejeve të drejtimit bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje.

Tabelat e ekuivalencës, lista e Modeleve të lejeve të drejtimit, të plotësuara me imazhet e modeleve të identifikuara në to, si dhe modeli i Vërtetimit të përmendur në nenin 8, përbëjnë Shtojcat Teknike të Marrëveshjes. Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Shtojcat Teknike janë ligjërish të detyrueshme. Ndryshe nga kjo Marrëveshje, Shtojcat mund të ndryshohen nga Palët në një formë të thjeshtuar përmes Shkëmbimeve të Notave Verbale. Ndryshimet dakordësuara, do të hyjnë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës së marrjes së Notës së përgjigjes. Pala që ka marrë Notën e përgjigjes do të njoftojë Palën tjetër për marrjen dhe për datën e saktë të hyrjes në fuqi.

Autoritetet qendrore përgjegjëse për konvertimin e lejeve të drejtimit janë si më poshtë:

- a) në Republikën e Shqipërisë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë – Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- b) në Republikën Italiane: Ministria e Infrastrukturës dhe Mobilitetit/ Lëvizshmërisë së Qëndrueshme – Departamenti i Transportit, Navigacionit, Çështjeve të Përgjithshme dhe Personelit;

Neni 7

Gjatë procedurave të konvertimit të lejeve të drejtimit, Autoritetet kompetente të Palëve tërheqin lejet e drejtimit që do të konvertohen dhe ua kthejnë ato Autoriteteve kompetente të Palës tjetër, përmes kanaleve diplomatike.

Për të dyja Palët, tërheqja e lejes së drejtimit që do të konvertohet bëhet vetëm pas dorëzimit të lejes së drejtimit të re, të lëshuar pas konvertimit.

Neni 8

Autoriteti kompetent që kryen konvertimin kërkon përkthimin zyrtar të lejes së drejtimit. I njëjti Autoritet mund të kërkojë informacion nga autoritetet kompetente të Palës tjetër, nëse linden dyshime në lidhje me vlefshmërinë, vërtetësinë e lejes së drejtimit dhe të dhënat e raportuara në të. Komunikimet zhvillohen në gjuhën italiane. Për t'iu përgjigjur kërkesave për informacion, autoriteti qendror kompetent përdor formularët e Vërtetimit bashkëngjitur në këtë marrëveshjeje.

Neni 9

Autoriteti qendror kompetent i Palës që merr lejen e drejtimit të tërhequr, pas konvertimit, informon Palën tjetër nëse dokumenti paraqet parregullsi në lidhje me vlefshmërinë, vërtetësinë dhe të dhënat e paraqitura në të. Ky informacion mund të shkëmbehet përmes rrugëve diplomatike ose drejtpërdrejt ndërmjet autoriteteve qendrore. Komunikimet zhvillohen në gjuhën italiane.

Neni 10

Palët informojnë njëra-tjetrën në lidhje me adresat e autoriteteve qendrore kompetente për zbatim, sipas të neneve 7, 8 dhe 9.

Secila Palë komunikon adresat e Përfaqësive të saj diplomatike të pranishme në territorin e Palës tjetër, në zbatim të neneve 7 dhe 9.

Neni 11

Kjo Marrëveshje do të zbatohet në përputhje me legjislacionin italian dhe shqiptar, si dhe me të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme dhe, përsa i përket Palës italiane, me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi i Italisë në Bashkimin Evropian.

Neni 12

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet në mënyrë miqësore përmes konsultimeve dhe negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet Palëve në rrugë diplomatike.

Neni 13

Kjo Marrëveshje, me Shtojcat Teknike përkatëse, do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës së marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet me të cilat Palët do të kenë komunikuar përmbushjen e procedurave të parashikuara nga legjilacionet përkatëse për hyrjen e saj në fuqi.

Marrëveshja mund të ndryshohet me shkrim me pëlqim të ndërsjellë dhe ndryshimet do të hyjnë në fuqi sipas të njëjtës procedurë të parashikuar për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes. Ndryshimet në Shtojcat Teknike do të hyjnë në fuqi në një formë të thjeshtuar në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 6.

Marrëveshja do të ketë një kohëzgjatje prej pesë vjetësh. Duke filluar një vit para përfundimit të afatit, Palët do të fillojnë konsultimet për të vijuar me rinovimin e kësaj Marrëveshjeje, në mënyrë që të mos ndodhë ndërprerja, qoftë edhe e përkohshme, e konvertimit të lejeve të drejtimit. Shkëmbimi i Notave për të zgjatur vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës së marrjes së Notës së përgjigjes. Në mënyrë që të lejojë të dy Palët të përcaktojnë datën e saktë të hyrjes në fuqi të çdo Shkëmbimi të Notave, Pala që ka


marrë Notën e përgjigjes do të njoftojë Palën tjetër përmes kanaleve diplomatike për datën e marrjes dhe datën e saktë e hyrjes në fuqi.

Marrëveshja mund të denoncohet me shkrim në çdo kohë nga njëra prej Palëve dhe do të pushojë së prodhuari efektet e saj gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit të denoncimit.

Në mirëbesim për sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar rregullisht, kanë firmosur këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në Tiranë, më 17 mars 2021, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe italiane, të gjitha tekstet janë njësoj autentike.

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**



**PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
ITALISË**



MODELET E LEJEVE TË DREJTIMIT

Modele të Lejeve të Drejtimit të lëshuara në Shqipëri renditur nga më i vjetri deri tek më i fundit.

1) Modeli i lejeve të drejtimit, lëshuar në Shqipëri nga data 01.07.2005 deri më 23.01.2017, sipas Udhëzimit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit n.17 datë 07.01.2003. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR). Ky model është i vlefshëm deri më 23.01.2027

2) Modeli i lejeve të drejtimit, lëshuar në Shqipëri nga data 24.01.2017 në bazë të Udhëzimit të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës n.241/3 datë 19.02.2016. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

Modelet e Lejeve të Drejtimit të lëshuara në Itali të renditura nga më i vjetri deri tek më fundit.

1) modeli i Lejes së Drejtimit MC 701/MEC . Autoriteti përgjegjës për lëshimin:- Prefekti. Lëshuar nga viti 1959 deri në 1989

2) modeli i Lejes së Drejtimit MC 701/N. Autoriteti përgjegjës për lëshimin:- Prefekti. Lëshuar nga viti 1989 deri 1990

3) modeli i Lejes së Drejtimit MC 701/C. Autoriteti përgjegjës për lëshimin - Prefekti. Lëshuar nga viti 1990 deri 1995

4) modeli i Lejes së Drejtimit MC 701/D. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: - Prefekti. Lëshuar në 1995

5) modeli i Lejes së Drejtimit MC 701/E. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: M.C.T.C. (Motorizimi Civil dhe Transporti me Koncesion). Lëshuar në vitin 1996

6) modeli i Lejes së Drejtimit MC 701/F lëshuar nga data 1 Korrik 1996 sipas Udhëzimit nr. 91/439 CEE. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: M.C.T.C. Lëshuar nga viti 1996 deri në 1997

7) modeli i Lejes së Drejtimit MC 701/ F. Numërtimi i të dhënave në faqen 2 krahasuar me modelin e pikës 6, është ndryshuar.
Autoriteti përgjegjës për lëshimin: M.C.T.C. Lëshuar nga viti 1997 deri në 1999

8) modeli i Lejes së Drejtimit MC 720 F sipas Udhëzimit nr. 96/47.
Autoriteti përgjegjës për lëshimin: M.C.T.C. Ky model mund të jetë në dy gjuhë (italisht- gjermanisht) vetëm nëse Leja e Drejtimit është lëshuar në Bolzano. Lëshuar nga viti 1999 deri në 2004

9) modeli i Lejes së Drejtimit MC 720 F sipas Udhëzimit nr. 96/47. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: M.C.T.C. Ndryshon nga e mëparshmeja sepse formulimi "patente di guida" ("Leje Drejtimi) në sfond është shkruar dhe në 10 gjuhët e shteteve që hynë në Bashkimin Evropian më 1 Maj 2004. Lëshuar nga viti 2005 deri në 2007

10) modeli i Lejes së Drejtimit MC 720 F sipas Udhëzimit nr.96/47. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: M.C.T.C.

Ndryshon nga e mëparshmeja e përshkruar në pikën 9) vetëm sepse numri i shtypur në pjesën e poshtme të anës së djathtë, në pjesën e prapme të dokumentit, nuk është prodhuar me shtyp por gdhendur me laser

engraving pra e deshifrueshme vetëm me prekje. Ky model mund të jetë në dy gjuhë (italisht- gjermanisht) vetëm nëse leja e drejtimit është e lëshuar në Bolzano. Lëshuar nga viti 2007 deri në 2013

11) modeli i Lejes së Drejtimit MC 720 P sipas Udhëzimit nr.2006/126. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: MIT (Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit) ose MC (Motorizimi Civil). Ky model mund të jetë në dy gjuhë (italisht-gjermanisht) vetëm nëse leja e drejtimit është lëshuar në Bolzano. Lëshuar nga viti 2013 deri në 2014

12) modeli i Lejes së Drejtimit MC 720 P sipas Udhëzimit nr. 2006/126. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: MIT ose MC. Ndryshon nga i mëparshmi treguar në pikën 11 sepse formulimi "patente di guida" në sfond, është shkruar edhe në gjuhën kroate. Lëshuar nga qershori i vitit 2014
Ky model mund të gjendet në dy gjuhë (italisht-gjermanisht) vetëm nëse leja e drejtimit është lëshuar në Bolzano. Lëshuar deri në tetor të 2014

I TABELA E EKVIVALENCËS

**Për konvertimin në dokumente italiane, të lejeve të drejtimit të lëshuara në Shqipëri deri më
23.01.2017**

SHQIPËRIA

ITALIA

A

A *

B

B *

C

C *

D

C + D *

BE

BE *

CE

CE *

DE

CE + DE *

* Për pajisjen me leje drejtimi të çdo kategorie titullari duhet të ketë mbushur moshën e kërkuar nga ligji italian (neni.4 – paragrafi 4).

II TABELA E EKVIVALENCËS

Për konvertimin në dokumente italiane, të lejeve të drejtimit të lëshuara në Shqipëri nga 24.01.2017

SHQIPËRIA

ITALIA

AM

AM *

A1

A1 *

A2

A2 *

A

A *

B1

B1 *

B

B *

C1

C1 *

C

C *

D1

D1 *

D

D *

BE

BE *

C1E

C1E *

CE

CE *

D1E

D1E *

DE

DE *

* Për pajisjen me leje drejtimi të çdo kategorie, titullari duhet të ketë mbushur moshën e kërkuar nga ligji italian (neni.4 – paragrafi 4).

III TABELA E EKVIVALENCES

Për konvertimin në dokumente shqiptare të lejeve të drejtimit të lëshuara në Itali

ITALIA	SHQIPËRIA
AM	AM *
A1	A1 *
A2	A2 *
A	A *
B1	B1 *
B (lëshuar para datës 01.01.1986)	A+B *
B (lëshuar nga data 01.01.1986)	B *
BE	BE *
C1	C1 *
C1E	C1E *
C	C *
CE	CE *
D1	D1 *
D1E	D1E *
D (lëshuar para datës 01.10.2004)	C+D *
D (lëshuar që prej datës 01.10.2004)	D *
DE (lëshuar para datës 01.10.2004)	C+DE *
DE (lëshuar që prej datës 01.10.2004)	DE *
CE+D	CE+DE *

* Për lëshimin e çdo kategorie titullari duhet të ketë mbushur moshën e parashikuar nga ligji shqiptar (neni 4 paragrafi 4)

Modeli 1

Da: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shqipëri
e-mail : dpshttr@dpshttr.gov.al

Për Zyrën e Motorizimit Civil të

e-mail _____

VËRTETIM i të dhënave në lidhje me lejen e drejtimit shqiptare nr.

1) TË DHËNAT PERSONALE TË TITULLARIT TË LEJEVE SË DREJTIMIT:

EMËR _____ MBIEMËR _____

DATA _____ E _____ LINDJES _____

VENDI _____ I _____ LINDJES _____ (Bashkia _____ ose
vendi) _____

2) Shënime të mundshme (për shembull: lente aparate dëgjimi.... etj...) :

3) Leja e drejtimit është e vlefshme. Skadon më _____

4) Data e marrjes së parë për secilën kategori:

5) Leja e drejtimit nuk i nënshtrohet masave kufizuese */ u nënshtrohet masave kufizuese vijuese

6) Leja e drejtimit nuk rrjedh nga konvertimi i një leje drejtimi tjetër të huaj */ rrjedh nga konvertimi i një leje drejtimi tjetër të huaj në shtetin që vijon:

Vendi dhe data

Drejtori

(*) shënoni rastin që nuk zbatohet

Modeli 2

Nga: *Ministria e Infrastrukturës dhe lëvizshmërisë*
Energjisë
së Qëndrueshme
Transportit

DP e Motorizimit

Italia

e-mail: patenti.mot5@mit.gov.it

Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe

Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve të

Rrugor

Albania

e-mail : dpshtrr@dpshtrr.gov.al

VËRTETIM i të dhënave në lidhje me lejen e drejtimit shqiptare nr.

1) TË DHËNAT PERSONALE TË TITULLARIT TË LEJEVE SË DREJTIMIT:

EMËR _____ MBIEMËR _____

DATA _____ E _____ LINDJES _____

VENDI _____ I _____ LINDJES _____ (Bashkia _____ ose
vendi) _____

2) Shënime të mundshme (për shembull: lente aparate dëgjimi.... etj...) :

3) Leja e drejtimit është e vlefshme. Skadon më _____

4) Data e marrjes së parë për secilën kategori:

5) Leja e drejtimit nuk i nënshtrohet masave kufizuese */ u nënshtrohet masave kufizuese vijuese

6) Leja e drejtimit nuk rrjedh nga konvertimi i një leje drejtimi tjetër të huaj */ rrjedh nga konvertimi i një leje drejtimi tjetër të huaj në shtetin që vijon:

Vendi dhe data

Drejtori

(*) shënoni rastin që nuk zbatohet

MODELET E LEJEVE TË DREJTIMIT SHQIPTARE

I. Modeli i lejes së drejtimit, lëshuar nga 01.07.2005 deri më 23.01.2017 (AL I)



II. Modeli i lejes së drejtimit, lëshuar nga data 24.01.2017 (AL II)



Modelet e lejeve të drejtimit italiane

Modeli 1

VERIFICAZIONI ANNUALI <table border="1" style="width: 100%; height: 150px; border-collapse: collapse;"> <tr><td style="width: 33%;"></td><td style="width: 33%;"></td><td style="width: 33%;"></td></tr> <tr><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td></td><td></td></tr> </table>																SOSPENSIONI DELLA PATENTE <table border="1" style="width: 100%; height: 150px; border-collapse: collapse;"> <tr><td style="width: 33%;"></td><td style="width: 33%;"></td><td style="width: 33%;"></td></tr> <tr><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td></td><td></td></tr> </table> NOTE: (1) Veicolo se mantiene rinvio fino a 75 cm e 75 cm (per tutti). (2) Anche se l'importo richiesto non supera il 10% del valore della patente non estende il periodo di validità della patente tale che il peso o il volume della patente non superi i 25 o 30. (3) La patente di categoria B abilita anche alla guida di macchine agricole, carrioli e macchine similari. (4) La guida dei ciclomotori e ciclomotori di cui al codice 74 del 1992, 2 della L. 79-74 che 42 è subordinata al rispetto autorizzativo.																Mod. MC 701/MEU  REPUBBLICA ITALIANA MINISTERO DEI TRASPORTI DIREZIONE GENERALE DELLA MOTORIZZAZIONE CIVILE E DEI TRASPORTI IN CONCESSIONE I PATENTE DI GUIDA PERMIS DE CONDUIRE

1. Cognome 2. Nome 3. Data e luogo di nascita 4. Residenza Via SS. Sanferro Rivoluzione, Cella UIT. Prov. di 5. Firma del Profeta di 6. U 7. Valore Anni Falsate N. IL PERMETTO Motto di bello e chiaro	CAMBIAMENTI DI RESIDENZA <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 50%;">Data</td> <td style="width: 50%; text-align: center;"> </td> </tr> <tr> <td>Firma</td> <td style="text-align: center;"> </td> </tr> <tr> <td>Data</td> <td style="text-align: center;"> </td> </tr> <tr> <td>Firma</td> <td style="text-align: center;"> </td> </tr> </table> FAC-SIMILE	Data		Firma		Data		Firma		(4) VETICOLI PER I QUALI LA PATENTE È VALIDA <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 50%;">A</td> <td style="width: 50%; text-align: center;"> </td> </tr> <tr> <td colspan="2">Motocicli di peso a vuoto fino a 4 quintali.</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td style="text-align: center;"> </td> </tr> <tr> <td colspan="2">Motocicli di peso a vuoto fino a 4 quintali, auto, ciclomotori, ciclomotori per trasporto, auto, ciclomotori (con motore a benzina e trasporto) e ciclomotori di peso a vuoto fino a 75 cm e 75 cm (3).</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td style="text-align: center;"> </td> </tr> <tr> <td colspan="2">Automobili, ciclomotori per uso speciale e trasporti specifici di peso complessivo a pieno carico oltre 35 kg e i trattori stradali (1).</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td style="text-align: center;"> </td> </tr> <tr> <td colspan="2">Autobus (1).</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td style="text-align: center;"> </td> </tr> <tr> <td colspan="2">Automobili di sig. A, B, C, D, per cui si deve a abilitazione, non prima, occup. (1) relativi titoli di sig. (1) sottostanti solo per sig. C e D).</td> </tr> </table>	A		Motocicli di peso a vuoto fino a 4 quintali.		B		Motocicli di peso a vuoto fino a 4 quintali, auto, ciclomotori, ciclomotori per trasporto, auto, ciclomotori (con motore a benzina e trasporto) e ciclomotori di peso a vuoto fino a 75 cm e 75 cm (3).		C		Automobili, ciclomotori per uso speciale e trasporti specifici di peso complessivo a pieno carico oltre 35 kg e i trattori stradali (1).		D		Autobus (1).		E		Automobili di sig. A, B, C, D, per cui si deve a abilitazione, non prima, occup. (1) relativi titoli di sig. (1) sottostanti solo per sig. C e D).	
Data																														
Firma																														
Data																														
Firma																														
A																														
Motocicli di peso a vuoto fino a 4 quintali.																														
B																														
Motocicli di peso a vuoto fino a 4 quintali, auto, ciclomotori, ciclomotori per trasporto, auto, ciclomotori (con motore a benzina e trasporto) e ciclomotori di peso a vuoto fino a 75 cm e 75 cm (3).																														
C																														
Automobili, ciclomotori per uso speciale e trasporti specifici di peso complessivo a pieno carico oltre 35 kg e i trattori stradali (1).																														
D																														
Autobus (1).																														
E																														
Automobili di sig. A, B, C, D, per cui si deve a abilitazione, non prima, occup. (1) relativi titoli di sig. (1) sottostanti solo per sig. C e D).																														

Modeli 2

VISMIAZIONI ANNUALI

SOSPENSIONI DELLA PATENTE

PATENTE DI GUIDA

REPUBLICA ITALIANA

MINISTERO DEI TRASPORTI

DIREZIONE GENERALE DELLA MOTORIZZAZIONE CIVILE E DEI TRASPORTI IN CONCESSIONE

I

PATENTE DI GUIDA

Idoneità

Adm. Istruzione

Permesso di Conduzione

Driving License

Permessi di Conduzione

Permessi

Carte di Conduzione

Modello della COMUNITA EUROPEA

1. Cognome 2. Nome 3. Data e luogo di nascita 4. Residenza 5. Circolo di appartenenza		6. Spazio riservato all'interessato	
7. a. Stato del Fratello di 7. b. 8. Valore del Bil. 9.		10.	

Modeli 3

SOSPENSIONI DELLA PATENTE		VALIDATION ANNUALE		REPUBBLICA ITALIANA  PATENTE DI GUIDA Istruzioni: Fulcrum Abbonamento Fornire la Conduzione Driving License Fornire la Conduzione Conduzione (Licenza) Istruzioni Fornire la Conduzione
Data Data	Data Data	Data Data	Data Data	
CONFERMA DI VALIDITA'		CONFERMA DI VALIDITA'		
Valida fino al Data Data		Valida fino al Data Data		

1. Cognome 2. Nome 3. Data e luogo di nascita 4. Indirizzo Via _____ Cap _____ Città _____	A B C D E	Colore per lo spid da porre in ordine Modello L di Spid	IMBALLAGGIO ADDIZIONALE

Modeli 5

[illegible]

1. Cognome _____

2. Nome _____

3. Data e luogo di nascita _____

4. Residenza _____
Via _____
Città _____

F. Immatricolazione
di
Matricola _____

FIGURA DEL TITOLARE

5. Matricola della M.C.T.C. di _____

6. di _____

7. Valore dell'anno di _____

8. Patente N. _____
IL DIRETTORE

Collegare per la quale la patente è valida

	Indirizzo per il quale la patente è valida	Indirizzo per il quale la patente è valida
A	Indirizzo per il quale la patente è valida	☐
B	Indirizzo per il quale la patente è valida	☐
C	Indirizzo per il quale la patente è valida	☐
D	Indirizzo per il quale la patente è valida	☐
E	Indirizzo per il quale la patente è valida	☐

1. Se il titolare della patente è un minore, la patente è valida per il periodo di validità della patente del titolare della patente.

2. Se il titolare della patente è un minore, la patente è valida per il periodo di validità della patente del titolare della patente.

3. Se il titolare della patente è un minore, la patente è valida per il periodo di validità della patente del titolare della patente.

4. Se il titolare della patente è un minore, la patente è valida per il periodo di validità della patente del titolare della patente.

5. Se il titolare della patente è un minore, la patente è valida per il periodo di validità della patente del titolare della patente.

6. Se il titolare della patente è un minore, la patente è valida per il periodo di validità della patente del titolare della patente.

7. Se il titolare della patente è un minore, la patente è valida per il periodo di validità della patente del titolare della patente.

8. Se il titolare della patente è un minore, la patente è valida per il periodo di validità della patente del titolare della patente.

9. Se il titolare della patente è un minore, la patente è valida per il periodo di validità della patente del titolare della patente.

10. Se il titolare della patente è un minore, la patente è valida per il periodo di validità della patente del titolare della patente.

INDICAZIONI ADDIZIONALI

Modelli 7

VEDIMAZIONI ANNUALI

CONFERME DI VALIDITÀ

CAMBIAMENTI DI RESIDENZA

SOSPENSIONI DELLA PATENTE

REPUBLICA ITALIANA

I

PATENTE DI GUIDA

Maraboni
Furterbach
Alfaro, mazzoni, mazzoni
Perrone de Compiègne
Gottlieb (Hans)
Perrone de Compiègne
Canonica, Thomas
Mazzoni
Corte de Compiègne
Mazzoni
Alfaro

Modello della
COMUNITA EUROPEA

FAC-SIMILE

1. Cognome _____
2. Nome _____
3. Data e luogo di nascita _____

4. Residenza _____
Via _____
C.A.P. _____
Prov. _____

5. Firma del titolare _____

6. Potere _____

7. Attestato dalla M.C.L.C. di _____

8. _____

9. _____

10. Velocità km/h _____

**Indicazione di dati
relativi alla
patente di guida**

Indicazioni aggiuntive

Categoria di veicolo per cui la patente è valida dal	Indicazioni aggiuntive
A	
B	
C	
D	
E	

Modelli 8



Modelli 9



PATENTE DI GUIDA

REPUBBLICA ITALIANA

1. _____

2. _____

3. _____

4a. _____

4b. _____

7. _____

8. _____

4c. _____

5. _____

SPECIMEN

9. _____

	9.	10.	11.	12.
A1 				
A 				
B 				
C 				
D 				
BE 				
CE 				
DE 				

Categoria "A" classe "A" (auto e ciclomotori) e classe "A1" (motori) rilasciata dal 2/4/2013. Validità fino al 31/12/2020.

Categoria "B" (auto) rilasciata dal 2/4/2013. Validità fino al 31/12/2020.

Categoria "C" (autoveicoli) rilasciata dal 2/4/2013. Validità fino al 31/12/2020.

Categoria "D" (autoveicoli) rilasciata dal 2/4/2013. Validità fino al 31/12/2020.

Categoria "BE" (autoveicoli) rilasciata dal 2/4/2013. Validità fino al 31/12/2020.

Categoria "CE" (autoveicoli) rilasciata dal 2/4/2013. Validità fino al 31/12/2020.

Categoria "DE" (autoveicoli) rilasciata dal 2/4/2013. Validità fino al 31/12/2020.

mod. MC 720F

ISTITUTO POLIGRAFICO E ZOOLOGICO EDIZIONE S.p.A. - OFFICINA CARTE WILSON

AB 0000000

Modelli 10



	9.	10.	11.	12.
A1 				
A 				
B 				
C 				
D 				
BE 				
CE 				
DE 				



PATENTE DI GUIDA REPUBBLICA ITALIANA

1.

2.

3.

4a.

4b.

5.

7.

4c.

9.

FACSIMILE

13.

9.	10.	11.	12.
AM 			
A1 			
A2 			
A 			
B1 			
B 			
C1 			
C 			
D1 			
D 			
BE 			
C1E 			
CE 			
D1E 			
DE 			

12.

FACSIMILE

1. Cognome 2. Nome 3. Data e luogo di nascita 4a. Data del rilascio
4b. Data di scadenza 4c. Rilasciata da 5. Numero della patente
10. Valida dal 11. Valida fino al 12. Codice

AE 0000000



PATENTE DI GUIDA REPUBBLICA ITALIANA

1.

2.

3.

4a.

4b.

5.

7.

9.

4c.

13.

9.	10.	11.	12.
AM 			
A1 			
A2 			
A 			
B1 			
B 			
C1 			
C 			
D1 			
D 			
BE 			
C1E 			
CE 			
D1E 			
DE 			

12.

AE 0000000

1. Cognome 2. Nome 3. Data e luogo di nascita 4a. Data del rilascio
 4b. Data di scadenza 4c. Filasquella da 5. Numero della patente
 10. Valida dal 11. Valida fino al 12. Categorie

mod. MC 7208